

Patentat Europiane dhe procedura e grantimit






Përmbajtja

- 4 Patenta
- 8 Patentat Europiane
- 18 Këshilla për Aplikantët
- 24 Procedura e grantimit

Patentat





Çfarë është një patentë?

Patentat mbrojnë shpikje teknike. Ato janë të vlefshme në shtete të përcaktuara për një periudhë specifike. Patentat përcaktojnë të drejtën për të ndaluar palët e treta nga përdorimi i shpikjes pa autorizim për qëllime tregëtare.

Por, në mënyrë që shpikja të jetë e mbrojtur, aplikantët duhet ta zbulojnë plotësisht atë. Aplikimet për patentë dhe patentat e grantuara publikohen, duke u bërë kështu një burim primar i informacionit teknik.

Çfarë është një shpikje?

Shpikje mund të jetë një produkt, një proces ose një aparat. Që të jetë e patentueshme, shpikja duhet të jetë e re, e aplikueshme në industri dhe të përbëjë një hap shpikës.

Si mund të kem mbrojtje patente?

Mbrojtja e patentës nuk është automatike. Duhet të depozitohet një aplikim i cili përshkruan shpikjen me detaje teknike dhe në një mënyrë që plotëson disa kriterë. Hapi i parë zakonisht është depozitimi i aplikimit në zyrën kombëtare të patentave.

Sipas Konventës së Parisit të vitit 1883, personi i cili depoziton një aplikim në një shtet mund të pretendojë “prioritet” në datën e aplikimit edhe për aplikime të mëvonta në shtete të tjera, nëse ato lidhen me të njëjtën shpikje dhe depozitohen brenda 12 muajsh nga aplikimi i parë.

Patentat dhe të drejta të tjera të pronësisë intelektuale

Idetë origjinale dhe puna kreative janë asete të cilat mund të kenë vlera tregtare në të njëjtën mënyrë si të mirat e tjera. Funkcioni i të drejtave të pronësisë intelektuale është vendosja dhe mbrojtja e pronësisë për patentat, modelet e përdorimit, të drejtat e autorit, markat dhe disenjot. E drejta e mbrojtjes varet nga disa procedura regjistrimi për markat tregtare dhe të drejtat e disenjove.

Patentat trajtojnë aspektet teknike dhe funksionale të shpikjeve.

Modelet e përdorimit mbrojnë shpikjet teknike të cilat nuk kualifikohen për patentë dhe mund të mbrohen në disa shtete nëpërmjet regjistrimit.

Të drejtat e autorit mbrojnë krijime si veprat letrare, kompozimet muzikore dhe punët e artit, transmetimet dhe programet kompjuterike nga kopjimi dhe përdorimi i paautorizuar.

Markat tregtare mundësojnë dallimin mes markave të produkteve dhe shërbimeve. Ato mund të përbëhen nga shenja dy-tre dimensionale si shkronjat, numrat, fjalët, figurat, logo ose piktura apo edhe tinguj.

Disenjot dhe modelet e përdorimit mbrojnë aspektin vizual të produkteve industriale si për shembull forma dhe ngjyra.

Cili është qëllimi i patentave?

Domethenia e lartë ekonomike e patentave vjen si rrjedhojë e të drejtave që pronari i patentës zotëron në ndalimin e palëve të treta nga shfrytëzimi ekonomik i shpikjes së tij, për një periudhë kohore deri në 20 vjet pas datës së aplikimit. Kjo u mundëson atyre rifitimin e kostove të zhvillimit dhe u jep kohë për të mbledhur shpërblimet nga investimi i tyre.

Mbrojtja efektive e patentave inkurajon investimet e mëtejshme në Kërkim dhe Zhvillim dhe është kërkesë thelbësore në rritjen e kapitalit. Ajo i jep shtysë inovacionit teknik i cili është thelbësor për konkurrencën dhe rritjen e përgjithshme ekonomike.


Detyrimi që ka aplikanti për të publikuar shpjegimin e plotë teknik të shpikjes jep nje kontribut të madh në shpërndarjen e dijes së re teknologjike. Tani, mbi 80% e dijes teknologjike të të gjithë botës, mund të gjendet në dokumentet e patentave. Kjo insipron shpikjet e tjera dhe në të njëjtën kohë parandalon dublikimin e punës për Kërkim dhe Zhvillim.


Ndalimi I të tjerëve për përdorimin e teknologjisë për përfitime ekonomike, pa lejen e pronarit, është një e Drejtë. Përdorimi dhe shfrytëzimi i teknologjisë është subjekt i ligjeve dhe rregullave kombëtare.

Patenta nuk garanton suksesin tregtar. Ajo tregon se ideja që përfaqëson është e re, e aplikueshme në industri dhe inovative. Zhvillimi i aspektit tregtar është në dorën e pronarit.

Qëllimi i patentave nuk është vendosja e monopoleve afatgjata. Ato jepen vetëm për një periudhë të limituar e cila mund të zgjatet në rastin e medikamenteve dhe pesticideve të cilat duhet ti nënshtrohen testimeve klinike të zgjatura për arsye sigurie për shëndetin.

Patenta Europeane





Cilat janë avantazhet e Patentës Europiane?

Konventa e Patentës Europiane bën të mundur mbrojtjen e patentës në rreth 40 vende europiane me një aplikim të vetëm (shiko hartën në faqen tjetër). Aplikanti ka të drejtë të zgjedhi shtetet në të cilët ai kërkon mbrojtje.

Patentat Europiane grantohen nga Zyra Europiane e Patentave nëpërmjet një procedure efektive si në kohë dhe kosto, në njërën nga gjuhët zyrtare të Zyrës: Anglisht, Frengjisht apo Gjermanisht.

Ato kanë të njëjtat efekte ligjore si patentat kombëtare të cilat grantohen në çdo shtet. Cdo patentë Europiane i nënshtrohet të njëjtës procedure të ekzaminimit në substancë, dhe mund të mbrohet gjithashtu në vende të cilat kanë vetëm sistem regjistrimi duke siguruar në këtë mënyrë një mbrojtje të fortë.

Termi, qëllimi i mbrojtjes, teksti dhe arsyet e refuzimit të patentave Europiane janë të njëjtat për të gjitha shtetet kontraktuese të Konventës Europiane të Patentave.

Kur duhet të depozitosh një aplikim për patentë Europiane?

Patentimi mund të jetë me kosto të lartë. Si çdo investim tjetër rreziku dhe benefitet duhet të llogariten dhe vlerësohen me kujdes. Gjithsesi, mbrojtja e patentës është e këshillueshme në një shtet në të cilin shpikja krijon pritshmëri në të ardhurat ekonomike. Është e arsyeshme për të aplikuar për një patentë europiane dhe jo patentë kombëtare kur mbrojtja kërkohet në të paktën 4 shtete Europiane.

Si mund të marrësh një patentë Europiane?

Të gjitha shtetet kontraktuese të Konventës Europiane të Patentave ofrojnë mundësinë që, si hap të parë, të aplikojnë për një patentë kombëtare. Depozitimi i një aplikimi për patentë kombëtare ka avantazh në kosto për arsye se aplikimi konsiderohet relativisht i lirë dhe aplikantët mund ti kryejnë procedurat e aplikimit në gjuhën lokale. Aplikanti ka 12 muaj kohë duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit për të aplikuar për të njëjtën shpikje, nëse vendos që ka nevojë për mbrojtje, në shtete të tjera. Aplikanti mund të kërkojë datën e prioritetit të aplikimit fillestar për aplikimet e mëvonshme. Një aplikim për patentë Europiane mund të pretendojë datën e prioritetit të një aplikimi kombëtar, ose mund të jetë vet aplikimi i parë, edhe pse nuk janë të shumta raste të tilla.

Një aplikim European mund të derivojë edhe nga një aplikim ndërkombëtar nëpërmjet Traktatit të Bashkëpunimit të Patentave (PCT). Ky traktat u ofron një procedurë të thjeshtuar aplikimi 148 shteteve në të gjithë botën duke u dhënë mundësi shpikësve të depozitojnë një aplikim ndërkombëtar të vetëm me efekt në shumë shtete, duke evituar aplikimin për çdo shtet për patenta kombëtare apo rajonale. Në këtë fazë bëhet kërkimi ndërkombëtar dhe nëse kërkohet edhe ekzaminimi ndërkombëtar paraprak. Në fazën kombëtare apo rajonale, procedura e grantimit bëhet nga zyra respektive e shtetit apo zyrat rajonale të patentimit, si p.sh. Zyra Europiane e Patentave.

Organizata Europiane e Patentave

Organizata është rritur që nga viti 1973 duke përfshirë 38 shtete anëtare, dy vende “shtrirje” dhe një shtet “vlefshmërie, kështu duke mbuluar një zonë prej më shumë se 600 milion banorësh.

Vendet Anëtare (38)

Shqipëri	Luksemburg
Austri	Malta
Belgjikë	Monako
Bullgari	F.Y.R.M
Kroaci	Hollandë
Qipro	Norvegji
Republika Çeke	Poloni
Danimarkë	Portugali
Estoni	Rumani
Finlandë	San Marino
Francë	Serbi
Gjermani	Sllovaki
Greqi	Slloveni
Hungari	Spanjë
Islandë	Suedi
Irland Itali	vicër
Letoni	Turqi
Liechtenstein	Britani e Madhe
Lituani	

Shtete “shtrirje” (2)


Shtete të cilat njohin Patentat Europiane nëse kërkohen dhe të cilat mund të bëhen shtete anëtare të Organizatës:

Bosnia-Herzegovina
Montenegro

Shtete “vlefshmërie” (1)

Shtete të cilat njohin patentat Europiane nëse kërkohen

Vendet e Zyrës Evropiane të Patentave



Çfarë mund të patentosh në Europë?

Sipas ligjit të Konventës Europiane të Patentave, patentat për shpikje që janë të reja, përbëjnë një hap shpikës dhe që janë të aplikueshme në industri. Një shpikje i plotëson këto kriterë nëse nuk është ekspozuar në publik në asnjë lloj forme apo mënyrë përveçse në datën e aplikimit apo në datën e prioritetit, nuk i duket e qartë një profesionisti të fushës dhe mund të prodhohet apo përdoret në industri.

Zbulimet, mënyrat matematike, programet kompjuterike dhe metodat e biznesit nuk konsiderohen si shpikje. Procedurat kirurgjikale dhe terapeutike si dhe metodat diagnostikuese të cilat praktikohen në trupin e njeriut apo atë të kafshëve, përjashtohen nga patentimi. Varietetet bimore apo shtazore përjashtohen tërësisht nga patentimi. Konventa Europiane e Patentave nuk njeh ato shpikje, përfitimi ekonomik i të cilave bie në kundërshtim me moralin dhe principet, të tilla si klonimi i jetës njerëzore ose përdorimi i embrionëve njerëzore për qëllime tregtare dhe industriale.

Sa është kostoja e një patente Europiane?

Kostoja e një patente Europiane varet nga numri i shteteve të zgjedhura për mbrojtje dhe termi i planifikuar i mbrojtjes. Depozitimi dhe kërkimi, pretendimi i 16-të dhe çdo pretendim shtesë për mbrojtje, shtrirje dhe publikim, së bashku me tarifat ripërtëritëse pas vitit të tretë pas datës së depozitimit dhe të gjitha vitet që vijojnë deri në grantimin e patentës.

Tarifat e depozitimit dhe kërkimit të cilat duhet të paguhen në fillim të procedurës arrijnë vlerën rreth 1'300 Euro. Shuma e tarifave që duhet të paguhen për pretendimet varet nga numri i pretendimeve nëse është më i madh se 15.

Tarifat e tjera paguhen më vonë. Kjo do të thotë që aplikantët mund të vendosin në çdo moment të procedurës për ta vazhduar atë apo jo.

Për të pasqyruar një vlerë të përafërt, momentalisht një aplikim për patentë Europiane kushton rreth 5'300 Euro për të arritur deri në fazën e grantimit.

Tarifat e pagesës së ripërtëritjeve kundrejt zyrave kombëtare të patentave të shteteve ku kërkohet mbajtja në fuqi e mbrojtjes së patentës, është në varësi të tarifës që aplikon shteti përkatës.

Pas grantimit

Pas fazës së grantimit, janë shtetet kontraktuese në të cilat është kërkuar mbrojtja e patentës Europiane të cilat e kanë kompetencën. Nëse patenta nuk është grantuar në një nga gjuhët zyrtare, disa nga këto shtete kërkojnë përkthimin e specifikimeve të patentës apo minimalisht të pretendimeve.

Aplikantët duhet të përdorin analizën e tregut për të zgjedhur se në cilat shtete ata kanë realisht nevojë për të mbrojtur patentën e tyre për arsye se kostot e përkthimit të patentës janë të larta.

Kostot e përgjithshme për marrjen e një patente Europiane në numrin më të madh të rasteve përfshijnë dhe kostot e avokatit të patentës. Më shumë detaje për këto kosto mund të jepen nga një avokat patentash i cili vepron si përfaqësues profesional përpara EPO-s.

Këshilla për aplikantët





Gjëra të cilat duhet të konsiderohen përpara depozitimit të aplikimit

Rreziqet e tregimit të shpikjes

Një informacion teknik i cili nuk është i ri për publikun nuk mund të mbrohet me patentë. Kjo do të thotë që, nëse një shpikje është hapur më parë për publikun apo është shitur, apo janë publikuar detajet teknike të saj, shpikësi nuk mund të fitojë më vonë mbrojtje të patentës.

Për këtë arsye, çdo diskutim me partnerë teknikë apo investitorët i cili bëhet përpara depozitimit të patentës, duhet të zhvillohet në konfidencë të plotë.

Fakti që shpikja nuk është akoma e disponueshme në tregti nuk tregon që është e re. Studimi i tregut, dokumentet akademike, gazetat tregtare dhe katalogët janë shumë të dobishëm por, patentat janë një burim shumë herë më i rëndësishëm informacioni për një pamje të plotë të teknologjive më të fundit.

Përdorimi i bazës së të dhënave të Espacenet, me mbi 60 milion dokumenta patentash, është mënyra më e mire për konsultim. Një kërkim i mirë për patentë të informon nëse shpikja është e re, përpara se të zotohesh për tarifat dhe kostot që lidhen me aplikimin e patentës. Shërbimi i Përkthimit të Patentës i cili ofrohet falas nga EPO, bën të mundur përkthimin e dokumenteve të patentave në një nivel të kënaqshëm për të dhënë një shpjegim të arsyeshëm të teknologjisë në një gjuhë të kuptueshme. Ky shërbim mundëson përkthimin dhe në Anglisht, Frengjisht dhe Gjermanisht për 27 gjuhë të tjera Europiane (duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të EPO-s) dhe gjithashtu nga Anglisht për gjuhën Kineze, Japoneze, Koreane dhe Ruse.

Gjithashtu është e mundur marrja e dokumenteve të patentave nga zyrat kombëtare të patentave po ashtu dhe nga libraritë Europiane nga e gjithë Europa. Këto të fundit mund të ndihmojnë edhe në kryerjen e kërkimeve nëse është e nevojshme.

Shiko www.epo.org/patlib-centres

A ka një treg?

Pasi janë konsultuar me këto burime informacioni, shpikësit duhet akoma të këshillohen për të vendosur nëse ka apo jo treg për shpikjen e tyre. Informacioni nga patentat mund të jetë shumë i dobishëm edhe në identifikimin e partnerëve në biznes dhe burimet e kapitalit.

Jo çdo shpikje e re është domosdoshmërisht më e mire se ajo që është aktualisht në treg, prandaj vendimi për patentimin e një teknologjie është një vendim biznesi. Pyetja: “A duhet të patentohet? “është më e rëndësishme se pyetja: “A mund të patentohet?”

Për më shumë informacion dhe mbështetje

Përpara se të aplikosh për një patentë rekomandohet për të kërkuar këshillë ligjore nga një avokat patentash.

Nëse rezidenca apo vendi kryesor i biznesit tuaj është një nga vendet e EPC, ju mund ti kryeni personalisht procedurat përpara EPO-s. Ju lutemi të keni parasysh se vlera e një Patente varet sa nga draft-imi i saj po aq dhe nga vet shpikja.

Nëse rezidenca apo vendi kryesor i biznesit tuaj nuk është një nga vendet Europiane , ju duhet të keni përfaqësues në procesin përpara Zyrës dhe personalisht mund të bëni vetëm depozitimin e aplikimit dhe pagesën e tarifave. Ju mund të përfshini një përfaqësues profesional përpara EPO-s ose një përfaqësues ligjor i cili është i autorizuar për të përfaqësuar aplikantët përpara Zyrës.

Shiko: www.epo.org/representatives

Në website-in e EPO ju mund të gjeni akses të shpejtë në FAQs, guidë për aplikantët, tarifat, formularët dhe mjetet.

Shiko: www.epo.org/service-support

Instanca të ndryshme në vendet anëtare të EPO ofrojnë këshillim dhe informacion në mbrojtjen e patentës, përdorimin e patentës dhe licencimin e saj, po ashtu dhe detaje të tjera për mundësitë e mbështetjes financiare. Masa kombëtare dhe Europiane janë vendosur për të promovuar inovacionin dhe financimin e kostove të patentës.

Për më shumë informacion ju mund të kontaktoni zyrën tuaj kombëtare të patentave ose qendra të tjera të patentave në vend. Për detaje në lidhje me taksat e patentave, shfrytëzimit të tyre ju mund të kontaktoni konsulentin tuaj fiskal ose zyrën lokale të taksave.



Procedura e grantimit





Depozitimi i një aplikimi për patentë

Aplikimet për patentë Europiane mund të depozitohen në Mynih, Hagë apo Berlin ose në zyrën e pronësisë industriale të çdo shteti të kontraktuar. Aplikimet mund të bëhen online, me postë, me faks apo të dërgohen me një person tjetër.

Gjuha e një aplikimi për patentë

Një aplikim për patentë mund të depozitohet në çdo gjuhë, por do të procesohet vetëm në një nga gjuhët zyrtare, Anglisht, Frengjisht dhe Gjermanisht. Për këtë arsye, nëse patenta është depozituar në një gjuhë tjetër, brenda dy muajve duhet të depozitohet version i përkthyer në Anglisht, Frengjisht apo Gjermanisht.

Përbërësit e një aplikimi për patentë Europiane

Aplikimet Europiane të Patentave përbëhen nga 5 pjesë: kërkesa për grantim; një përshkrim i shpikjes; një apo me shumë pretendime; vizatim që përfshihet në përshkrimet e pretendimeve(nëse ka); dhe abstrakti. Pas depozitimit, subjekti i aplikimit për patentë europiane nuk mund të shtrihet më shumë se përmbajtja e aplikimit ashtu si është depozituar.

Kërkesa për grantim

Kërkesat duhen kryer duke përdorur formularin zyrtar të Kërkesës për Grantim i cili mund të merret pa pagesë, i shoqëruar nga shpjegimet e plotësimit, nga Zyra Europiane e Patentave dhe zyrat e patentave të shteteve anëtare. Gjithashtu formulari mund të shkarkohet në: www.epo.org/forms

Përshkrimi i shpikjes

Përshkrimi i shpikjes duhet të jetë i qartë dhe i plotë në mënyrë që një person i aftë të mund ta procesojë. Përshkrimi përbën bazën e pretendimeve.

Pretendimet

Pretendimet duhet të përcaktojnë subjektin për të cilën kërkohet mbrojtja e patentës sipas termave të veçorive specifike. Ato duhet të jenë të qarta dhe të sakta dhe të mbështeten nga përshkrimi.

Vizatimet

Aplikimi mund të përmbajë edhe vizatime. Këto përbëjnë një informacion shtesë kur ilustrjnë veçoritë e shpikjes


Abstrakti

Abstrakti është tërësisht informacion teknik dhe nuk përdoret për të aksesuar patentueshmërinë e shpikjes.

Procedura e grantimit në një shikim të vetëm

Aplikanti

Zyra Europiane e Patentave Domaini Publik



Depozitimi dhe ekzaminimi i formaliteteve

Hapi i parë në procedurën e grantimit të një patente Europiane është ekzaminimi i depozitimit. Kjo përfshin kontrollin nëse i gjithë informacioni dhe dokumentacioni është sjellë, në mënyre që aplikimi të marrë një datë depozitimi. Duhet të plotësohen: një indikacion i cili tregon interesin e kërkimit të një patente Europiane, veçanërisht identifikimin e aplikantit dhe një përshkrim apo referencë të një aplikimi i cili është depozituar më parë. Nëse pretendimet nuk janë depozituar bashkë me aplikimin, ato duhet të depozitohen brenda 2 muajve.

Procedura vazhdohet nga ekzaminimi “formal” i cili trajton disa aspekte të aplikimit, duke përfshirë formularin dhe përmbajtjen, përkthimin, emertimin e shpikësit, caktimin e një përfaqësuesi profesional dhe pagesa e tarifave.

Kërkimi

Në të njëjtë kohë me ekzaminimin e formaliteteve hartohet edhe një raport kërkimi i cili liston të gjitha dokumentet që i vihen në dispozicion zyrës të cilat konsiderohen të rëndësishme për të provuar inovacionin dhe hapin shpikës. Raporti i kërkimit bazohet në pretendimet e patentës duke konsideruar gjithashtu përshkrimin dhe vizatime të mundshme. Pasi hartohet raporti i kërkimit i dërgohet menjëherë aplikantit së bashku me një kopje të të gjitha dokumenteve të cituar dhe me opinionin paraprak nëse shpikja e pretenduar dhe aplikimi përmbushin kriteret e Konventës Europiane të Patentave.

Publikimi i aplikimit

Aplikimi publikohet së bashku me raportin e kërkimit 18 muaj pas datës së depozitimit apo datës së prioritetit. Duke filluar nga kjo datë, aplikantët kanë 6 muaj për t'u përgjigjur nëse ata duan të vazhdojnë me procedurat e aplikimit duke kërkuar një ekzaminim në substancë. Nëse një aplikant i cili e ka kërkuar më parë ekzaminimin në substancë, atij do ti kërkohet një konfirmim për të vazhduar me procedurat e aplikimit.

Duke filluar nga data e publikimit, një patentë Europiane gëzon mbrojtje të përkohshme në shtetet e zgjedhura në aplikimin e publikuar. Megjithatë, bazuar në ligjet kombëtare të shteteve të zgjedhura, mund të jetë e nevojshme për të depozituar në zyrat e patentave përkthimin e pretendimeve dhe publikimin e tyre.

Ekzaminimi në substancë

Në të njëjtë kohë me ekzaminimin e formaliteteve hartohet edhe një raport kërkimi i cili liston të gjitha dokumentet që i vihen në dispozicion zyrës të cilat konsiderohen të rëndësishme për të provuar inovacionin dhe hapin shpikës. Raporti i kërkimit bazohet në pretendimet e patentës duke konsideruar gjithashtu përshkrimin dhe vizatime të mundshme. Pasi hartohet raporti i kërkimit i dërgohet menjëherë aplikantit së bashku me një kopje të të gjitha dokumenteve të cituar dhe me opinionin paraprak nëse shpikja e pretenduar dhe aplikimi përmbushin kriteret e Konventës Europiane të Patentave.

Grantimi i një patente

Grantimi i një patente Europiane është një grup patentash individuale kombëtare. Në një pjesë të madhe të vendeve kontraktuese, që një patentë të gëzojë efektin e mbrojtjes dhe mbrohet kundër shkeljeve, duhet të bëhet e vlefshme.

Kjo do të thotë që, pronari i patentës duhet të depozitojë përkthimin e specifikimeve ose të paktën të pretendimeve në gjuhën zyrtare të shtetit ku kërkohet vlefshmëria. Gjithashtu edhe pagesat kanë afatet e tyre. të gjitha këto përcaktohen nga ligjet e shtetit.

Kundërshtimet

Pasi patenta Europiane është grantuar, ajo mund të kundërshtohet nga palët e treta të cilat zakonisht janë konkurrentët e aplikantit, me pretendimin se patenta nuk është inovative apo nuk përbën një hap shpikës.

Kundërshtimet duhet të depozitohen brenda 9 muajve nga grantimi i përmendur në Buletinin European të Patentave. Ekzaminimi i kundërshtimeve menaxhohet nga divizionet për kundërshtimet në Zyrën Europiane të Patentave, të cilat përbëhen po ashtu nga 3 ekzaminues.

Palët e treta mund të paraqesin vërejtjet e tyre në lidhje me patentimin e shpikjes pas publikimit të një aplikimi përpara EPO, për aq kohë sa ky aplikim është akoma në proces.

Refuzimi ose kufizimi

Pronari i patentës mund të kërkojë kufizim ose refuzim të patentës në çdo kohë pasi është grantuar.

Apelimi

Vendimet e Zyrës Europiane të Patentave të cilat lidhen me çështje të refuzimit të aplikimi apo kundërshtimit të tij, mund të apelojnë.

Vendimet në apel merren nga bordi i apelit i cili është një organ i pavarur i EPO-s.

Publikuar nga

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, Shqipëri
©DPPM 2016

Përgjegjës për përmbajtjen

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Dizajn

AAG Publicity

Përkthyer nga:

AAG Publicity

Përkthim i edituar nga:

Drejtoria e Koordinimit, Promovimit të PI dhe Trajnimeve
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave

Printim

AAG Publicity

Botimet mund të shkarkohen pa pagesë nga faqja e internetit e EPO-s në adresën:

www.epo.org/teaching-kit.

“E Drejta e Autorit dhe Lirimi nga Përgjegjësia: Ky material është krijuar, përkthyer apo adaptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave **(DPPM)** me mbështetjen e Zyrës Europiane të Patentave **(EPO)**.

EPO nuk garanton që materiali nuk përmban gabime apo mungesa në të dhe zhvishet nga çdo përgjegjësi që lidhet me besueshmërinë e saj apo me pazotësinë e saj në përdorime dhe dëmtime të tjera të mundshme të kësaj natyre, humbje të informacionit, fitime apo të ardhura.

Versioni original mund të jetë i disponueshëm në:

www.epo.org”



www.epo.org
info@epo.org



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

**Adresa: Bulevardi “Zhan D’Ark”,
Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë
Tel: +335(0)42236288,
Email: info@dppm.gov.al**